



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	38/22
Nr. i fq. / Br. st	- 6 -
Datum / Datum	14. 2. 2022
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e I-rë e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
24 janar 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifë (kryesuese), Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollë dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i komunës), Shpëtim Zhegrovë, Nënkyetar i komunës, drejtoret e drejtive, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Lidhur me Draft-Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, ju njoftojmë se kanë qenë disa gabime teknike dhe së bashku me sekretarinë e kemi përgatitur nga një kopje tjetër, Ajo tha se ka ardhur një pikë që të futet në të ndryshme “Themelimi i komisionit për zgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave”.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021;
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i kërkesës të Sindikatës të Shërbysesve Civilë – dega në Vushtrri për kompensimin e shujtës për punëtorët e administratës komunale;
5. Shqyrtimi i Propozim – buxhetit për vitin 2022;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
7. Shqyrtimi i peticionit nga ish – banorët e fshatit Skoçan përfshirjen në buxhetin e viti 2022, asfaltimin e rrugës që lidh fshatin Skoçan me Vushtrrinë;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelim të komisionit për zgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave.
9. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se ky është një raport i viti të kaluar dhe se për shkak se është obligim ligjor, e kemi sjellë në kuvend. Pasi që ky raport nuk ka qenë gjatë mandatit tim, nuk kam ndonjë gjë për të diskutuar, por nëse ka dikush ndonjë pyetje, jemi të hapur për të diskutuar.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – deklaroi se është dashur të bëhet një rezyme e përgjithme, sepse nuk kemi marrë një raport të gjendjes. Ai tha se zyrtari kryesor financiar është dashur që ta përgatit një dokument unik, në mënyrë që ne të njoftohem lidhur me qëllimin dhe përbushjen e objektivave strategjike, të cilat determinojnë politikat vjetore të qeverisjes komunale. Ai tha se do të ishte mirë që këto raporte të jenë të detajuara, si për neve anëtarët e kuvendit, por edhe për opinionin e gjerë.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se ka pasur mangësi në këtë raport, por së shpejti do të merremi me instalimin e serverit, i cili do të na mundësojë raportimin në kohë reale dhe besoj që në të ardhmen do të përmirësohet forma e raportimit.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekmando që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se ekzistojnë disa gabime teknike dhe është mirë që për kuvend të përmirësohen. Në muajin prill thuhet se <Raporti vjetor i ndërmarrjes regionale “Mitrovica”>, për cilën ndërmarrje është fjala, a mund të na sqaroni?

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – deklaroi se kjo është pikë që ka ardhur nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se si pikë ka ardhur nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe do të konsultohemi lidhur me këtë dhe për kuvend do ta sjellim të përmirësuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekmando që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se ky plan është i ndarë në shtatë objektiva: 1. Zhvillimi ekonomik; 2. Rinia, kultura, avancimi i gruas dhe sporti; 3. Arsimi; 4. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale; 5. Infrastruktura dhe mbrojtja e ambientit; 6. Administrata, si dhe 7. Turizmi. Po ashtu, janë të zbërthyera edhe aktivitetet për vitin 2022, si dhe janë të planifikuara edhe të hyrat që do t'i realizojmë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se iu kisha sugjeruar që të përmirësohen disa gabime teknike.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se në faqen 2 janë planifikuar: <Riorganizimi dhe reformimi i sektorit të shëndetit oral>; <Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në shtëpi për persona të palëvizshëm> Konsideroj se është dashur që të ketë edhe prioritete tjera. Po ashtu, në faqen 18-19, nuk kemi asnje fjalë të vetme lidhur me menaxhimin e pandemisë Covid 19, mënyrën se si do t'i qaseni. Konsideroj se duhet të hyjë si objektivë edhe menaxhimi i pandemisë Covid 19.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – u shpreh se pajtohet lidhur me atë që të jetë pjesë e objektivave edhe menaxhimi i situatës me Covid 19. Po ashtu edhe gabimet teknike do të përmirësohen.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i kërkesës të Sindikatës të Shërbyesve Civilë – dega në Vushtrri për kompensimin e shujtës për punëtorët e administratës komunale

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se është një kërkesë e arsyeshme. Të gjithë kemi vullnet për t'i përkrahur dhe për t'i përbushur këto kërkesa, por jemi në një situatë të pafavorshme me buxhetin. Sepse, buxhetin e këtij viti po e fillojmë me një deficit përmbi 2 milionë e 300 mijë euro nga investimet kapitale, dhe në anën tjetër duke i llogaritur suficitet për katër vite është një shumë e madhe. Prapë ju jeni ata që vendosni, por sugjerimi im do të ishte që të shkojë në zyrën ligjore për një opinion ligjor se a ka bazë ligjore për kompensim të shujtave për punëtorët e administratës.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – tha se në kërkesë po ceket që ekziston edhe një vendim i kuvendit i vitit 2010, që nuk është i bashkëngjitur. Prandaj, është mirë që t'i bashkëngjitet edhe ai vendim, si dhe zyra ligjore është dashur që të marrë pjesë në këtë mbledhje.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – edhe unë pajtohem me parafolësin që zyra ligjore është dashur të jetë prezent që vazhdimesh ka qenë. Ne si grup kuvendar i mbështesim të gjitha kërkesat që vijnë nga sindikatat që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve. Prandaj, ndoshta është mirë ta procedojmë në kuvend dhe ta zhvillojmë një debat më të gjerë lidhur me këtë çështje.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se lidhur me këtë kërkesë duhet të shikohet edhe kostojë financiare, sepse është një kosto e lartë financiare për mbulimin e shujtave për punëtorët e administratës. Por, dyshoj edhe në aspektin ligjor se a kemi të drejtë për një gjë të tillë, se nga cili burim i financimit të bëhet kompensimi. Paraprakisht duhet të dërgohet një zyrën ligjore për një opinion ligjor dhe nëse është konform ligjit ne do ta përkrahim.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se Agroni e përmendi vendimin që është marrë në kuvend. Ai vendim me sa më kujtohet është marrë në vitin 2010, kur unë kam qenë kryesues i kuvendit dhe nuk e di se pse ka mbetur pa u nënshkruar. Prandaj, a jeni që ta dërgojmë në zyrën ligjore për një opinion ligjor, apo ta procedojmë në kuvend dhe ta diskutojmë edhe më gjerë.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – u shpreh se edhe unë pajtohem që të shkojë në zyrën ligjore për një opinion ligjor dhe mund të procedohet në seancën e radhës për diskutim dhe të planifikohet, pasi që është në shqyrtim edhe buxheti për vitin 2022.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – tha se ndarja e buxhetit bëhet në vija buxhetore dhe te pagat e mëditjet nuk është i specifikuar buxheti. Prandaj, nëse opinioni ligjor nga zyra ligjore është pozitiv, atëherë edhe në seancën e muajit shkurt mund ta marrim një vendim.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet në zyrën ligjore për një opinion ligjor, se a ka bazë ligjore për këtë çështje.

5. Shqyrtimi i Propozim – buxhetit për vitin 2022

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se gjatë këtyre ditëve kemi punuar intensivisht me drejtoritë komunale për hartimin e këtij projekt – buxheti. Prandaj, kërkoj nga ju që ta votojmë këtë projekt – buxhet dhe të fillojmë me realizimin e projekteve.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – thekosi se buxheti total për vitin 2022 është 19,862,886 euro, <paga dhe mëditje> kemi 10,720,000.00 euro, <mallra dhe shërbime> kemi 3,278,239 euro, <shpenzime komunale> kemi 428,000.00 euro, <subvencione> kemi 657, 540.00 euro dhe <shpenzime kapitale> kemi 4,779,107.00 euro.

Obligime kontraktuale që i kemi trashëguar nga viti 2021 janë 2,385,947 euro, për investime kapitale kemi 2,393,159 euro. Granti i përgjithshëm për vitin 2022 është 7,115,388 euro, granti i arsimit është 7,882,034 euro, granti i shëndetësisë është 2,425,419 euro. Ai tha se të hyrat vetanake që i planifikojmë për vitin 2022 janë 2,262,795 euro.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se ka projekte të mira që meritojnë të përkrahen, por po e shoh një përqëndrim të buxhetit në urbanizëm dhe shërbime publike në raport me drejtoritë tjera. Kryetari edhe gjatë fushatës ka premtuar orientim të buxhetit në arsim, kulturë, shëndetësi, e të cilat nuk janë pasqyruar në këtë projekt – buxhet.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – tha se kërkesat tona do t'i paraqesim në kuvend.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – lidhur me çështjen që e ngriti z. Mehollı për orientim të buxhetit në urbanizëm dhe shërbime publike, ai tha se kemi obligime kontraktuale nga viti 2021 dhe për këtë arsyë është rritur buxheti në këto fusha.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – theksoi se për kuvend do të ishte mirë ta bëjë drejtoria një aneks lidhur me obligimet kontraktuale se cilat janë ato projekte.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – kërkoi sqarime se si është bërë propozimi nga komunitetet joshumicë për anëtarësim në këtë komitet. A është bërë me thirrje publike, apo në çfarë forme?

Haki Maloku, nga zyra e kryetarit – tha se sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ për themelim të komitetave të përhershme, Kryetari i komunës ju bën kërkesë përfaqësuesve të

komuniteteve joshumicë që jetojnë në komunë. Ky propozim është bërë me shkrim në kohën e duhur dhe të gjitha propozimet kanë ardhur nga komunitetet joshumicë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se komuniteti boshnjak ka kërkuar takim me mua lidhur me këtë çështje, pra përfaqësim në këtë komitet.

Haki Maloku, nga zyra e kryetarit – theksoi se duhet ta shikojmë numrin e komunitetit boshnjak në bazë të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 se sa boshnjakë janë regjistruar në Vushtrri.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – tha se do të ishte mirë që të përcaktohet numri se sa anëtarë ju takojnë partive politike që të dihet për kuvend.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – tha se në kuvend do të votohet çelësi.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se komunitetet joshumicë me siguri kanë mbajtur mbledhje për t'i dhënë propozimet e tyre. Prandaj, për hir të transparencës është mirë të na bashkëngjiten procesverbalet e atyre mbledhjeve.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i peticionit nga ish – banorët e fshatit Skoçan për përfshirjen në buxhetin e vittit 2022, asfaltimin e rrugës që lidh fshatin Skoçan me Vushtrrinë

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – sa e pash kjo ka ardhur si kërkesë, jo si peticion. Prandaj, është mirë të bashkëngjitet në kuadër të buxhetit.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se e dimë që kuvendi e ka për obligim t'i shqyrtojë peticionet, dhe ne e përkrahim që të vjen për diskutim në kuvend. E dimë që kjo është një rrugë e gjatë, por konform mundësive financiare të fillojë si projekt që brenda 3-4 viteve të përfundojë. Ai tha se në projekt-buxhet a është planifikuar <asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra>, kurse pyeti se në qytet a është planifikuar ndërtim i rrugëve vetëm me kubëza, dhe nuk do të ketë asfaltim fare, si është çështja?

Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – theksoi se kemi menduar që me një kontratë kornizë dyvjeçare t'i përfshijmë rrugët me prioritet më të madh që janë nëpër fshatra, kurse në qytet kemi filluar me rrugë më të shkurtra me kubëza, por për rrugë më të gjata nuk kemi pasur kërkesë deri më tanë për t'i trajtuar me asfalt, përveç rikonstruimit.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – theksoi se ka të drejtë Sylejmani që e ceku këtë çështje, sepse titulli duhet t'i ndërrohet në projekt – buxhet dhe të bëhet <Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra dhe qytet>.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelim të komisionit për zgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave


Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se është obligim ligjor që kuvendi ta themelojë këtë komision prej dy anëtarëve, kurse një anëtar e cakton Ministria e Arsimit. Ekzistojnë dy mundësi lidhur me mandatin e komisionit: <mandat njëvjeçar> dhe < me mandat të kuvendit> Ne kemi menduar që të jetë me mandat njëvjeçar, në mënyrë që të shikohet performanca e komisionit.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri vendosi që seanca e kuvendit të komunës të mbahet më 31 janar 2022 në ora 10:00.

9. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **12:10**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe e KPF- së